


**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**

Nr. 203 Rep.

Nr. — Kol.



**KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH**

Ne qytetin e Tiranës, sot me date 07 Korrik 2003 (dymij e tre), para meje noter *N. Murati*, anetar i Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht palet:

**SHITESJA** : Lucia Maria BERTINO, e bija e Giacomo Bertinos dhe e Maria Piras, e datelindjes 31.03.1952, lindur ne Itali ne Ivrea(TO) banuese ne Itali ne adresen Via della Serra N1 IVREA (TO), madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e se ciles u sigurova nga Pasaporta personale me Nr.A321166.

**BLERESI**: *Fatos Çuçi*, i biri i Edipit dhe i Myrvetes, i datelindjes 23.12.1950, me banim ne Tirane, ne rrugen "Gjik Kuqali", pallati "Melros", madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta e tij me nr. Z0539561;

**PALET**: kerkuan perpilimin e kesaj *Kontrate per shitje kuotash te shoqerise* "ALFA SHERBIMET" (Alfa Services) sh.p.k. dhe deklaruan sa me poshte vijon:

Me vendimin Nr 3343 dt 01.04.1994 te Gjykates se Shkalles se pare Tirane eshte regjistruar shoqeria tregtare "ALFA SHERBIMET" (Alfa Services) sh.p.k. Ortaket themelues te saje jane znj. Lucia Maria Bertino dhe z. Fatos Çuçi te cilet zoterrojne nga 50% te kapitalit themeltar sejcili.

Me vendimin e asamblese se ortakeve te shoqerise "ALFA SHERBIMET" (Alfa Services) sh.p.k. dt 07.07.2003 eshte lejuar shitja e plot e kuotave te zoteruara nga ortakja znj. Lucia Maria Bertino ne favor te ortakut tjeter z. Fatos Cuci.

Per sa me siper *Shitesja* Lucia Maria Bertino si zoteruese 50% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise prej 100.000 leke, deklaroun se me vullnetin e saje te lire dhe te plote ja shet teresisht keto kuota te kapitalit themeltar te shoqerise ortakut tjeter z. Fatos Çuçi me nje cmim te pergjithshem prej 50.000lek.

**Bleresi** : *Fatos Çuçi* deklaroun se me vullnetin e tij te lire pranon blerjen teresisht te kuotave te mesiperme qe zoterohen nga shitesja Lucia Maria Bertino ne kapitalin themeltar te shoqerise ne shumen 50.000 leke dhe se e gjithë shuma objekt i kesaj kontrate i eshte dorezuar shiteses jashte zyres se Noterit, shume te cilen ajo deklaroun se e ka marre plotesisht.

Me likujdimin e shumes se sipercituar dhe nenshkrimin e kesaj kontrate shitesia Lucia Maria BERTINO c'vishet teresisht nga pronesia e kuotave te shoqerise "ALFA SHERBIMET" (Alfa Services) sh.p.k, ndersa blersi Fatos Çuçi

behet pronar i vetem i kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "ALFA SHERBIMET" (Alfa Services) sh.p.k :

Bashkengjitur me kete Kontrate, nje kopje e vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane, nr.3343, date 01.04.1994 si dhe vendimi i asamblese se ortakve dt 07.07.2003.

Kjo kontrate pasi u lexua me ze te larte dhe u gjet e shkruar sipas vullnetit te plote dhe te lire te paleve nenshkruset rregullisht prej tyre dhe une Noteri e vertetoi ate sipas ligjit.

**P A L E T**

**SHITESI**

Lucia Maria BERTINO

LUCIA MARIA BERTINO  
Lucia Maria Bertino

**BLERESIT**

Fatos ÇUÇI

Fatos Çuçi  
Fatos Çuçi

**NOTER**

Mexia Muxeta  
Muxeta

